

VENDIM
Nr. 106/2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.
87/2018 “PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PARLAMENTAR ‘PËR
NDJEKJEN DHE MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 12/2018 ‘PËR
VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË
SHTETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E
BRENDSHME DHE ANKESAT NË MINISTRINË E BRENDSHME””**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21/1 e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Pavarur,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën IV, të vendimit të Kuvendit nr. 87/2018 “Për ngritjen e nënkomisionit parlamentar ‘Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018 ‘Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme””, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Deputeti Nimet Musaj (GP) caktohet anëtar i nënkomisionit.

II. Pas pikës IV, shtohet pika IV/1, me këtë përmbajtje:

“IV/1. Anëtarë zëvendësues në këtë nënkomision janë:

1. Xhemal Qefalia (PS);

2. Antoneta Dhima (PS);

3. Ylli Shehu (GP).

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 12.9.2019